

RREGULLORE

SE ORGANIZIMIT DHE  
FUNKSIONIMIT TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT



# UNIVERSITETI I SHKODRES

## “Luigj Gurakuqi”

BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 66 prot.

Shkodër, më 15.03 2017

V E N D I M

nr. 35, datë 15.03 2017

### “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SE ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT”

Në mbështetje të Ligjit nr.80, dt.22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 8480, date 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 15.03 2017

Vendosi

1. Të miratojë miratojë rregulloren e organizimit dhe funksionimit të Bordit të Administrimit bashkangjitur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDUARD NDRECA



**RREGULLORE**  
**E ORGANIZIMIT DHE**  
**FUNKSIONIMIT TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT**  
**TË**  
**UNIVERSITETIT TË SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"**

Neni 1

Veprimtaria e Bordit të Administrimit bazohet në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, Ligjit nr. 8480, date 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike" dhe ne Statutin e Universitetit të Shkodrës.

Neni 2

Qëllimi i Rregullores

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i rregullave të përgjithshme të veprimtarisë dhe funksionimit të Bordit të Administrimit (këtu e në vijim BA) të USH në përputhje me objektivat dhe misionin ligjor të tij, si dhe mënyrën e zbatimit të tyre.

Neni 3

Fusha e zbatimit

Kjo rregullore zbatohet për veprimtarinë e BA në ushtrim të funksioneve dhe kompetencave të tij.

Neni 4

Përkufizim

"Bordi i Administrimit" është organ më i lartë kolegjial vendimmarrës që mbikëqyr dhe kontrollon veprimtarinë e USH në aspektet administrative, financiare dhe ekonomike, si dhe në ushtrimin e mbrojtjen e të drejtave të pronësisë publike të USH.

Neni 5

Përbërja dhe krijimi i Bordit të Administrimit

1. Bordi i Administrimit, përbëhet nga 7 anëtarë, të punësuar me kohë të pjesshme respektivisht:
  - a) Tre anëtarë, të zgjedhur nga Senati i Universitetit;
  - b) Katër anëtarë, të emëruar nga Ministri i Arsimit dhe Sportit.
2. Përbërja e BA përcaktohet në varësi të planit buxhetor afatmesëm të Universitetit të miratuar nga BA.
3. Kryetari i Bordit zgjidhet nga anëtarët e tij me shumicë absolute.

Neni 6  
Mandati i anëtarëve të Bordit të Administrimit

1. Mandati i anëtarit të BA është 5 vjeçar. Mandati i autoritetit ose i anëtarit mbaron para kohe në rastet kur:
  - a. jep dorëheqjen;
  - b. mungon pa arsye në katër seanca mbledhjesh radhazi të BA;
  - c. kryen shkelje të rënda të ligjit në ushtrim të detyrave në BA;
  - d. dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
  - e. është në kushtet e pamundësisë për të kryer detyrën;
  - f. largohet nga universiteti;
  - g. ndryshon raportin e përfaqësimit në BA;
2. Vendi i mbetur vakant i anëtarit të zgjedhur nga Senati, plotësohet sipas renditjes në listën përkatëse të kandidatëve. Kur nuk ka të tillë, Rektori thërret zgjedhjet për plotësimin e vendit vakant.
3. Vendi i mbetur vakant i anëtarit që përfaqëson Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, emërohet nga Ministri i Arsimit dhe Sportit.

Neni 7  
Funksionet e BA

1. BA ka këto funksione kryesore:
  - a. Garanton qëndrueshmërinë financiare të Universitetit dhe përmbushjen e misionit të tij.
  - b. Me propozim të Senatit Akademik:
    - i. Miraton planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tij;
    - ii. Miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre;
    - iii. Miraton numrin e personelit në të gjitha nivelet.
  - c. Miraton paraprakisht hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive përbërëse të Universitetit;
  - d. Vlerëson paraprakisht mbylljen dhe riorganizimin e institucionit të arsimit të lartë, si dhe ndarjen ose bashkimin e Universitetit me një institucion tjetër të arsimit të lartë;
  - e. Jep mendim për projekt-rregulloren e organizimit dhe funksionimit administrativ të universitetit dhe miraton rregulloren financiare të tij.
  - f. Përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron Universiteti nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit.
  - g. Emëron dhe shkarkon administratorin e Universitetit.
  - h. Miraton emërimin dhe shkarkimin e administratoreve të Njësive Kryesore.
  - i. Miraton paraprakisht Statutin e Universitetit, para se t'i përcillet Senatit Akademik.
  - j. Miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së Universitetit, të hartuar nga Rektori.

- k. BA miraton masat administrative të propozuara nga drejtuesit e strukturave të USH.
  - l. Përcakton kriteret dhe procedurat për emërimin e Administratorit të Universitetit.
  - m. Përcakton kriteret dhe procedurat për punësimin e administratorëve dhe personelit administrativ.
2. BA ka edhe funksione të tjera, të cilat përcaktohen shprehimisht në Ligjin për Arsimin e Lartë në RSH dhe aktet nënligjore përkatëse, si dhe në Statutin e USH.

#### Neni 8

#### Roli dhe përgjegjësitë e Kryetarit të BA

1. Kryetari është drejtues ekzekutiv i punës së përditshme të BA.
2. Kryetari ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
  - a. drejton mbledhjen dhe diskutimet, si dhe siguron zbatimin e ligjit dhe marrjen e vendimeve të drejta.
  - b. mund të shtyje ose mbyllë mbledhjen para kohë në situata dhe rrethana të përligjura.
  - c. Vendos për datën dhe kohën e mbledhjes së radhës. Nëse ka ndryshime për datën dhe orën, ai bën njoftimin për çdo anëtar për t'ua bërë të njohur ndryshimin.
  - d. Përcakton rendin e ditës për çdo mbledhje duke ia shpërndarë të gjithë anëtarëve të paktën 5 dite para mbledhjes.
  - e. në rastet kur në një mbledhje nuk janë të pranishmen më shumë se 50% e anëtarëve, ai vendos për thirrjen e mbledhjes në një ditë tjetër të paktën 24 ore pas te parës.
  - f. voton i fundit. (shënim: këtë e kam spostu më poshtë tek neni i votimit)
  - g. deklaron mbylljen e diskutimit, përmbledh pikat e rëndësishme dhe deklaron fillimin e votimit.
  - h. Me ftesë të kryetarit mund të marrin pjesë në mbledhje ekspertë dhe teknikë të administratës së Universitetit për të paraqitur qartësimet e mundshme për çështje të veçanta. Me ftesë të tij në mbledhje mund të marrin pjesë të ftuar nga rektorati dhe administrata me funksione të asistencës teknike - administrative.


#### Neni 9.

#### Kalendari i mbledhjeve

1. Bordi i Administrimit funksionon në baze të mbledhjeve të cilat janë të zakonshme dhe të jashtëzakonshme, në zbatim të kompetencave që ka BA.
2. Mbledhjet e jashtëzakonshme thirren me iniciativë të Kryetarit ose me paraqitjen e kërkesës me shkrim të motivuar të 1/3 e anëtarëve. Rendi i ditës propozohet nga anëtarët iniciues.
3. Mbledhja zhvillohet kur janë të pranishëm mbi 50% e anëtarëve, përveç rasteve kur duhet prania e të gjithë anëtarëve.

#### Neni 10.

#### Thirrja e mbledhjeve



1. Mbledhjet e zakonshme te Bordit të Administrimit thirren nëpërmjet njoftimit me shkrim ose me e-mail, te paktën 5 dite para ditës se vendosur për zhvillimin e mbledhjes.
2. Thirrja duhet patjetër te përmbaje rendin e ditës, ditën, orën dhe vendin e mbledhjes.
3. Lajmërimi për mbledhje i bashkëngjiten materialet dokumentare dhe shpjeguese ne lidhje me rendin e ditës të cilat përgatiten nga zyrat e administratës sipas problematikave të rendit të ditës.

Neni 11  
Modifikimi i rendit te ditës

Propozimet për të ndryshuar rendin e ditës mund të propozohen nga Kryetari ose një anëtar i BA. Këto propozime duhet te miratohen nga BA.

Neni 12.  
Vlefshmëria e mbledhjeve

Mbledhjet e Bordit te Administrimit janë te vlefshme nëse:


- a. Te gjithë anëtarët janë vënë në dijeni rregullisht sipas kërkesave të kësaj rregulloreje;
- b. marrin pjesë shumica e anëtareve që përbëjnë BA.

Neni 13  
Iniciativa propozuese për vendimmarrjen në BA

1. Të drejtën e iniciativës për vendimmarrje përpara BA e kanë:
  - a. Cdo anëtar i BA
  - b. Senati i USH
  - c. Rektorati i USH
  - d. Administratori i USH
  - e. Struktura të tjera të USH në përputhje me kompetencat dhe përgjegjësitë përkatëse, sipas akteve ligjore e nenligjore ne fuqi.
2. Cdo propozim për vendimmarrje që paraqitet përpara BA nga subjektet e pikave a-e të paragrafit të mësipërm, duhet të ketë të bashkëngjitur relacionin shpjegues si dhe projekt-vendimin përkatës.

Neni 14.  
Diskutimet

1. Diskutimi hapet nga kryetari, duke parashtruar çështjet që do të diskutohen sipas rendit të ditës.
2. Anëtarët në diskutimet e tyre mund te prezantojnë amendamentet për propozimet e hedhura dhe duhet t'i argumentojnë gjatë kohës së ndërhyrjes. Si rregull, asnjë nga anëtarët nuk mund të ndërhyje më shumë se një herë gjatë diskutimit të të njëjtit argument.
3. Deklarimi i votës, për rastet kur bëhet votim i hapur, mund të bëhet pas diskutimit dhe para se të kalohet në votim.



4. Çdo anëtar mund të marrë fjalën për të ilustruar arsyet e votës së tij, duke shtuar dhe argumente të parashtruara gjatë diskutimit të mëparshëm.
5. Në fillim të çdo diskutimi mbi një argument, kryetari mund të përcaktojë kohën për të folur për çdo ndërhyrje.
6. Ndryshimet eventuale mbi çdo propozim të bërë votohen përpara vendimit përfundimtar.

#### Neni 15

#### Procesverbali i mbledhjes

1. Procesverbali i mbledhjes së BA mbahet nga Sekretari i BA. Në procesverbal pasqyrohen: procedura e mbledhjes së Bordit të Administrimit, ora, data dhe vendi i zhvillimit, anëtarët që marrin pjesë, diskutimet e zhvilluara, vendimet që merren, forma dhe rezultati i votimeve.
2. Procesverbalet e çdo mbledhjeje zbardhen, si rregull brenda 30 ditëve, nga sekretari dhe miratohen në mbledhjen pasardhëse. Procesverbali përmban ilustrimet e çështjeve të trajtuara, të shoqëruara me shënimet përkatëse, tekstet vendimeve të marra dhe rezultatet e votimeve, si dhe ndërhyrjet e bëra dhe deklaratimet e votave të kërkuara nga të interesuarit.
3. Procesverbali shpjegon votat pro dhe kundër të shprehura nga çdo anëtar i pranishëm dhe firmoset në mbledhjen pasardhëse.
4. Procesverbali i kalon për miratim anëtarëve që kanë marrë pjesë, në fillim të mbledhjes pasardhëse. Nëse ka vërejtje për mënyrën e zhvillimit të mbledhjes apo temës së mbledhjes, ato pasqyrohen në procesverbal. Pas miratimit të procesverbalit nga anëtarët e BA-së, ai nënshkruhet nga Kryetari dhe Sekretari.

#### Neni 16.

#### Votimi dhe format e tij

1. Anëtarët e BA-se, janë të detyruar të marrin pjesë në votim, shprehja e votës bëhet e ditur me ngritje dore ose me apel nominal.
2. Vendimet e Bordit, votohen nga të gjithë anëtarët e pranishëm.
3. Vendimet merren me votim të hapur me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe.

Vendimet, që përmbajnë vlerësime mbi sjelljen dhe cilësitë e anëtarëve të BA ose për sjelljen dhe cilësitë personale të atyre për të cilat vendimi sjell pasoja, merren me votim të fshehte.

#### Neni 17

#### Marrja e vendimeve

1. Vendimmarrja në BA realizohet me shumicë të thjeshtë të votave me përjashtim kur në ligj kërkohet një shumicë absolute ose e cilësuar.
2. Anëtarët e BA-se nuk mund të abstenojnë.
3. Nëse në një proces të hapur votimi ka barazim të votave, rezultati i votimit përcaktohet nga vota e kryetarit.
4. Vendimi për miratimin e Statutit të USH merret me shumicë të cilësuar sipas ligjit për Arsimin e Lartë në RSH.



Neni 18.  
Publikimi i vendimeve

1. Vendimet e Bordit të Administrimit behën publike. Ato i drejtohen zyrave të administratës për veprim, dhe sipas kërkesës se atyre që kane interes.
2. Ne rast se kërkohet nga shumica e anëtareve, vendimet e Bordit të Administrimit publikohen në website të Universitetit.

Neni 19.  
Komisionet

1. Për çështje specifike, Bordi i Administrimit mund të ngrëjë "Komisione Speciale" me detyra studimi. Bordi i Administrimit përcakton periudhat e punës se komisioneve, si dhe përbërjen e tyre.
2. Komisionet e formuara ne këtë mënyre janë te hapura për te gjithë anëtarët e BA. Në këto komisione mund të ftohen për te kontribuar anëtarë të rektoratit dhe administratës se Universitetit.

Neni 20.  
Përgjegjësia

Anëtarët e BA janë ligjërisht përgjegjës për veprimet apo vendimet e marra.

Neni 20.  
Konfidencialiteti

Ecuria e mbledhjes, çdo diskutim apo debat i bere nga anëtarët e BA dhe kushdo që merr pjese në mbledhje gjatë zhvillimit te saj, konsiderohen konfidenciale.

Neni 21  
Pagesa

Pagesa e anëtarëve të BA behet sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 22  
Ruajtja e arkivës

Procesverbalet, vendimet dhe çdo dokumentacion i shqyrtuar në mbledhjet e BA ruhen dhe arkivohen në përputhje me përcaktimet e Ligjit për Arkivat.

Neni 23  
Ndryshimi i Rregullores

çdo ndryshim i kësaj Rregulloreje realizohet me vendim të BA të marrë me shumicën e votave të anëtareve që përbëjnë BA.

Neni 24  
Hyrja në fuqi

| Kjo Rregullore hyn në fuqi që nga data e miratimit të saj.

